



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
 Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
 Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	17.07.2025
REFERENC-Ë:	24/6006/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Eurofisi" Sh.p.k. për veprimtarinë: Fabrikë për prodhimin e stiroporit, Radivojc, Viti
CC:	Komisioni për shqyrtimin e kërkesës për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës së MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për ndërprerje të procedurës administrative

Të nderuar/ a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "Eurofisi" Sh.p.k. me Nr.Prot.24/6006/MMPHI, për veprimtarinë: Fabrikë për prodhimin e stiroporit, Radivojc, Viti.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur,

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/6006/MMPHI
Datë: 17.07.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 2 dhe 3 të nenit 10 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Ndërpritet procedura administrative e shqyrtimit të kërkesës me Nr.Prot. 24/6006/MMPHI për t'u pajisur me Leje Mjedisore, për operatorin "Eurofisi" Sh.p.k. për veprimtarinë: Fabrikë për prodhimin e stiroporit, në ngastrën kadastrale nr.259-2, zona kadastrale, Radivojc, Viti.

A r s y e t i m

Pas pranimit të kërkesës për Leje Mjedisore me Nr.Prot. 24/6006/MMPHI për operatorin "Eurofisi" Sh.p.k. Fabrikë për prodhimin e stiroporit, në ngastrën kadastrale nr.259-2, zona kadastrale, Radivojc, Viti, MMPHI konstaton që operatori **nuk ka plotësuar** kushtet administrative për t'u pajisur me Leje Mjedisore.

Kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisore i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr.13/99, të dt.30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor

MMPHI, ka kontrolluar dokumentacionin dhe ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve si në vijim:

- Pëlqimin nga AME për rezervuarin e naftës;
- Kontratë me kompaninë për grumbullin e mbetjeve nga procesi teknologjik

Operatori ka sjellë dokumentacion shtesë si në vijim:

- Pëlqimin nga AME për rezervuarin e naftës dhe
- Kontratën me kompaninë për grumbullin e mbetjeve nga procesi teknologjik

Operatori nuk ka sjellë dëshmi për plotësimin e dokumentacioneve të lartë cekura.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, **ndërpren procedurën administrative** për shqyrtimin e kërkesës për t'u pajisur me Leje Mjedisore, në përputhje me paragrafi 2 dhe 3 të nenit 10 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.04/2022 për Leje Mjedisore.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës-Viti;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.